



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Data: 20.05.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 19.05.2025 të parashtruar nga **OE PLUS TRADE LLC, Ferizaj**, për aktivitetin e prokurimit me titull: **Ndërtimi dhe Rikonstruimi i ndriqimit publik në rrugën, Sadik Shala, Ganimete Tërbeshi, dhe Afrim Zhitia në Lipjan**, me nr të prokurimit: **613-25-1854-5-2-1**

V E N D I M

I Refuzohet, kërkesa për ri-shqyrtim OE **PLUS TRADE LLC, Ferizaj**, për aktivitetin e prokurimit me titull: **Ndërtimi dhe Rikonstruimi i ndriqimit publik në rrugën, Sadik Shala, Ganimete Tërbeshi, dhe Afrim Zhitia në Lipjan** me nr të prokurimit: **613-25-1854-5-2-1**

Vërtetohet Vendimi i AK i publikuara në platformën e prokurimit i datës: 14.05.2025, i propozuar për kontratë OE **Anesi SHPK Prishtine**

1. **Mbetet në fuqi** Vendimi i AK i publikuar në Platformën e Prokurimit i datës: 14.05.2025
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit të lartëpërmendur.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Pretendimi juaj i Parë:

Operatori Ekonomik PLUS TRADE LLC, kundërshton vendimin e dhënë nga AK-se pasi këtu në këtë rast është konflikt interesi dhe janë përdorur veprime diskriminuese dhe favorizuese, pasi që me dokumentacionet që ka paraqitur OE i propozuar për dhënie të kontratës ANESI Shpk është i papërgjeshëm dhe ka bërë ujdi me OE tjetër i cili ka aplikuar njëjtë në këtë procedurë të prokurimit me të njëjtat dokumentacione (infrastruktura njerezore -stafi punonjës i njëjti, makinerië-e gjithë makineria e njëjte, materialeve-trupat ndricues të njëjte, prodhuesi i njëjte dhe vetëm me cmim me të ndryshme, gjë që le të aludohet në mënyrë të qartë që kanë bërë marrëveshje në mes vete, pasi nuk ka mundësi që me trupat ndriques të njëjte- të këtë diferencë në këtë mënyrë në cmime sipas procesit verbal(i'u

AK në këtë rast është dashur të eliminojë MENJEHERE të dy këto OE (ANESI SHPK dhe MVR E SHPK) të dyshimta dhe të vazhdojë me vlerësimin dhe krahasimin e tendereve me OE të tjere të përgjeshëm dhe serioz.

Përgjigje për pretendimin tuaj të Pare:

AK ka vlerësuar në përpikëri ofertat pjesëmarrëse në këtë AP poashtu pas përfundimit të vlerësimit ka nxjerr edhe OE me qmim me të lirë të përgjeshëm ashtu siq edhe është kërkuar në kërkesat e AK-se.

Pretendimi juaj që OE i propozuar për kontratë ka përdorur staf të njëjtë dhe makina të njëjta me një OE tjetër nuk paraqet problem duke u bazuar edhe në ligjin e prokurimit publik sepse këto kontratë do të fitoj vetëm një OE dhe jo 2 poashtu neve nuk mund të ndikojmë tek vendosja e qmimeve të OE sepse ajo është e drejtë e qdo OE të paraqes qmimet e veta për realizimin e kontratës dhe ky pretendim i juaj nuk qëndron.

Pretendimi juaj i parë është i Pa Bazuar.

Pretendimi juaj i Dytë:

Lidhur me kërkesën e) Min Dy punëtor të certifikuar për instalim të ndriqimit publik. AK me rastin e përgatitjes së dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë për këtë aktivitet të prokurimit e ka cekur në FTD që OE duhet të prezantojë 2 punëtorë të certifikuar për instalim publik ndërsa në listën e prezentuar nga ANESI Shpk janë prezentuar dy punëtorë të cilët janë të certifikuar si instalues elektrik – ndërsa kërkesa në FTD ka qenë që duhet të jenë të certifikuar për instalim të ndricimit publik, pra askund në FTD dhe në dosje të

Përgjigje për pretendimin tuaj të Dytë:

OE i propozuar për kontratë ka paraqitur stafin e nevojshëm duke u bazuar në kërkesën e AK, sa i përket këtij pretendimi për OE e propozuar për kontratë duhet të ju njoftojmë që nuk qëndron sepse i njëjti ka paraqitur punëtorët e certifikuar për instalime dhe ky kriter është plotësuar

Pretendimi juaj i dytë është i Pa Bazuar.

Përgjigje për pretendimin tuaj të Tretë:

Duhet të ju sqarojmë që AK ka për detyrë të vlerësojë ofertat në bazë të kërkesave të parashtruara dhe askund në kërkesat e AK nuk është kërkuar që të dizajnohen formatet e listave dhe të kontratave poashtu në vlerësojmë secilën ofertë duke u bazuar në kërkesat e parashtruara dhe në kemi përzgjedhur OE me qmim me të lirë të përgjeshëm si fitues.

Pretendimi juaj i tretë është i Pa Bazuar.

Pergjigje per pretendimin tuaj te katert dhe peste

OE ka paraqitur kerkese per qasje ne E-Prokurim ne ora 17:08 minuta me dt 14.05.2025, AK permes sistemit te E Prokurim ju ka njoftuar me dt 15.05.2025, ne ora 8:41, minuta se qasjen mund ta pranoni nga ora 13:00, te datës 15.05.2025, dita pare, ndersa ne ora 10:15, është ruajtur file te cilin ju e keni quajtur te modifikuar qe nuk është e vertet modifikimi apo ndryshimi i dyshimeve te juaja, siq shifet ne menyre kronologjike u pershkrua si ka rrjedhe ngarja te cilen edhe ju vet e dini shume mire, juve si OE ju ka dhane qasje sipas kerkeses tuaj poashtu edhe keni pranuar qasjen nga ana e AK, Sqarim gjate shkarkimit te dosjeve te OE neve na duhet qe ti ruajm ne nje fajll te veçant poashtu nese hapet nje fajll i excelit dhe mbyllet qdo her vete programi e paraqet daten e fundit te mbylljes, te gjith OE qe kane ngarkuar paramasen ne formatin Excel ju paraqitet ashtu ju i keni terhekur edhe dosjet tjera dhe shikoni qe njejt ju paraqitet edhe per tjerat dosje sa i perket ketij pretendimi tuaj kjo gje mund te verifikohet lehte ne platformen e prokurimi nga organet tjera si KRPP dhe OSHP qe te njejten mund ta beni ju. Kurse sa i perket a ju kan hapur fajllat apo jo keni pasur mundesi te vini apo te kerkoni sqarim shtese dhe ne ju ishim pergjigjur sepse ne nuk mund te dime se qfare kompjteresh apo qfar programe keni apo skeni fare programe per hapjen e fajllave neve ne kompjuteret tane nuk kemi pasur kete problem te gjith fajllat jane hapur.

Gjithashtu keni mundur të kërkonte permes adreses elektronike e cila është e publikuar së bashku me DT nëse file juaj nuk është hapur.

Ky pretendim i juaji eshte i pabzauar.

Pretendim i juaji i kater dhe peste eshte i Pa Bazuar

AK ka zbatuar me përpikëri rregullat e nxjerra nga KRPP,

Drejtori i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lartë ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-së duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi të këtij vendimi.

Data: 20.05.2025

Bekim Shabani

Drejtore i Prokurimit